



Datë: 03.03.2025
Numër Protokollit: 1956/2025

A.nr.152/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.152/2025, të datës 21.01.2025, të parashtruar nga ankuesi B.V, kundër organit të punësimit: Agjencia e Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, në çështjen juridike “*transferim me rastin e ristrukturimit*”, në mbështetje të nenit 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenit 16, paragrafi 3 dhe nenit 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si bazuar ankesa me numër A.nr.152/2025, e datës 21.01.2025, e parashtruar nga ankuesi B.V, ashtu që, **anulohet** Vendimi me Nr. 75/2024, i datës 23.12.2024, i zv. Udhëheqëse së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, si dhe **anulohet** pika e Raportit të Ristrukturimit Ref.Nr.01809/20244 të datës 02.12.2024, më renditje nr. 15, në lidhje me propozimin për transferim të ankuesit, ndërsa, lëndë kthehet në **rishqyrtim dhe rivendosje** tek organi i njëjtë-Komisioni i Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare për Verifikim dhe Krahasim të Pronës.

II. Obligohet Komisioni i Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij të veproj sipas pikës I të dispozitivit duke e bërë rishqyrtimin e rastit të ankueses në pajtim me pikëpamjet ligjore si në arsyetim të vendimit dhe në pajtim të plotë më dispozitat ligjore në fuqi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil B.V (*referuar tutje vetëm ankuesi*), më datë 21.01.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.75/2024 të datës 23.12.2024 të zv. Udhëheqëse së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.01.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (tutje referuar AKKVP), ndërsa, kjo e fundit më datë 30.01.2025 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me provat lidhur me çështjen në procedurë ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 398/2025 të datës 21.01.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 75/2024 të datës 23.12.2024 të zv. Udhëheqëse së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës; Vendimin A.nr.1071/2024 të KPMSHCK; Aktvendim AA.nr.973/2024 i Gjykatës së Apelit të Kosovës; Emailin e datës 26.12.2024 nga ankuesi për S.A; Emailin e datës 10.01.2025 nga S.A për ankuesin; Dëshmi nga Thesari i Kosovës për pagën e ankuesit për muajin dhjetor 2024; Akt Emërimit e datës 06.01.2025; Kopjen e ID-së së ankuesit; Plotësimin e ankesës datë 28.02.2025; Vendimin për pushim i datës 27.01.2025 miratuar nga ankuesi për E.M; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 14.02.2025 për nëpunësin E.M i bërë nga ankuesi; Konkursin me Nr. Reference RN00016383 për pozitën Udhëheqës i Zyrës Regjionale në Mitrovicë; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 23.01.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 30.01.2025; Akt Emërimit e datës 23.12.2011; Vendimin Ref.nr.00561/24 i datës 25.04.2024 për emërimin e Komisionit të Ristrukturimit; Raportin Ref.Nr.01809/2024 i datës 02.12.2024 i Komisionit të Ristrukturimit; Përshkrimin e detyrave të punës së pozitës Zyrtar i Lartë për Koordinimin Regjional; Përshkrimin e detyrave të punës së pozitës Zëvendës Udhëheqës i Zyrës Regjionale në Mitrovicë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, ndërsa lënda duhet të kthehet në **ri-shqyrtim** dhe **rivendosije** tek organi i njëjtë, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, dhe së i njëjti sipas Aktit të Emërimit të datës 23.12.2011, ka ushtruar pozitën e punës “Zëvendës Kryesues i Zyrës Regjionale në Mitrovicë.

Tutje nga provat e lëndës rrjedhë së Agjencia e Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronës ka miratuar Rregulloren Nr.01/2024 për Standardet e Organizmit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, dhe si rezultat i miratimit të kësaj rregullore, më datë 25.04.2024, Zyrtari Kryesor Administrativ me Vendimin Rer.nr.00561/24, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit, ndërsa, ky i

fundit më datë 02.12.2024, ka miratuar Raportin Ref.Nr.01809/24, ku lidhur me procesin e ristrukturimit të ankuesit ka rekomanduar citojmë:*pasi që pozita me titull Zëvendës Kryesi është shuar në strukturës e re organizative, komisioni propozon që zyrtari në fjalë të sistemohet në klasë profesionale në zyrën regjionale në Mitrovicë në pozitën Zyrtar i Lartë për Koordinim. Në bazë të dosjes zyrtari është rekrutuar në pozitë profesionale edhe nuk ka pasur asnjë procedurë rekrutimit për pozitë drejtuese. Në zbatim të rekomandimit të Komisionit të Ristrukturimit, Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore në AKKVP më Vendimin Nr.75/2024, të datës 23.12.2024, ka transferuar ankuesin në pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Koordinim Regjional në kuadër të Zyrës Regjionale në Mitrovicë/Departamenti për Koordinim Regjional.*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konteston ligjshmërinë e Vendimit me Nr. 75/2024 të datës 23.12.2024 të zv. Udhëheqëse së Divizionit të Burimeve Njerëzore në AKKVP, duke pretenduar së vendimi i kundërshtuar me ankesë është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe është tendencioz, ngase është transferuar nga pozita zëvendës Kryesues i Zyrës Regjionale në pozitë Zyrtar i lartë për Koordinim Regjionale.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me të drejtën e tij të sistemimit për shkak të riorganizimit, Kolegji i Këshillit, iu referua dispozitave të nenit 66 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunëse/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion; 2.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësja/i; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet komisioni i ristrukturimit që shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunëse/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunëses/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës. 4. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia përgjegjëse në bazë të propozimit të komisionit. 5. Nëpunësja/i mund të refuzojë transferimin vetëm për arsyet e parashikuara në paragrafin 3. të nenit 63 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil. 6. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3. të këtij neni, drejtohet nga njësia përgjegjëse dhe në të bëjnë pjesë përfaqësuese të institucioneve të parashikuara në nën-paragrafët 2.1., 2.2., 2.3. apo 2.4. të këtij neni, sipas rastit ku bëhet ristrukturimi përkatës...*

Në kuptim të vendosjes meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, iu referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë përkitazi me rregullimin e procedurës së transferimit të nëpunësve civil në rast të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, respektivisht mori për bazë nenin 66 i cili përcakton se: *“1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunëse/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion; 2.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin*

që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësja/i; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet komisioni i ristrukturimit që shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunëse/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunëses/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës. 4. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia përgjegjëse në bazë të propozimit të komisionit. 5. Nëpunësja/i mund të refuzojë transferimin vetëm për arsye të parashikuara në paragrafin 3. të nenit 63 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil. 6. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3. të këtij neni, drejtohet nga njësia përgjegjëse dhe në të bëjnë pjesë përfaqësuese të institucioneve të parashikuara në nën-paragrafët 2.1., 2.2., 2.3. apo 2.4. të këtij neni, sipas rastit ku bëhet ristrukturimi përkatës. 7. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton procedura të hollësishme për zbatimin e këtij neni. 8. Rregullat për zbatimin e këtij neni për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve”.

Rrjedhimisht, referuar kuadrit ligjor si më lartë dhe në vështrim të së drejtës së nëpunësit në procesin e ristrukturimit, Kolegji ka analizuar Rregulloren Nr. 01/2024 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në AKKVP dhe si rrjedhojë ka konstatuar së pozita e ankuesit si “Zëvendës Kryesues i Zyrës Regjionale”, në kuadër të Zyrës Regjionale në Mitrovicë nuk është paraparë në strukturën e re organizative, atëherë edhe ankuesi si rezultat i shuarjes së pozitës duhet ti nënshtrohet procedurës së ristrukturimit duke respektuar në përpikëri kërkesat ligjore sipas nenit 66 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë. Gjegjësisht nga analizimi i provave materiale të lëndës Kolegji vlerëson së Komisioni përkatës i Ristrukturimit i themeluar më Vendimin Rer.nr.00561/24, të datës 25.04.2024, nuk ka vepruar drejtë lidhur me procedurën e transferimit të ankuesit sepse ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 23.12.2011, ka ushtruar pozitën e punës “Zëvendës Kryesues i Zyrës Regjionale”, në kuadër të Zyrës Regjionale në Mitrovicë e të cilën pozitë ankuesi e ka ushtruar deri në marrjen e vendimit të kundërshtuar me ankesë dhe së duke u bazuar në përshkrimin e detyrave të detyrave të punës të dërguar nga AKKVP, pozita e Zëvendës Udhëheqësit të Zyrës Regjionale në Mitrovicë klasifikohet si pozitë e nivelit drejtues, me koeficient 9.5, ku në pikën 9 citohet: *Qëllimi i vendimit të punës: nen mbikëqyrje të drejtpërdrejt të Udhëheqësit të Zyrës Rajonale, Zëvendës Udhëheqësi i Zyrës Rajonale mbështet Udhëheqësin e Zyrës Rajonale në të gjitha aktivitetet në zyrë ku ai/ajo është emëruar dhe zëvendëson Udhëheqësin e ZR , në mungesë të tij...kurse në pikën 15 të përshkrimit të detyrave të punës për pozitën Zëvendës Udhëheqës i Zyrës Rajonale si kërkesa për këtë pozitë të punës janë përcaktuar: ... Diplomë universitare në Menaxhment, Shkenca Sociale, Drejtësi dhe të ngjashme, minimumi 6 vjet përvoje relevante profesionale përfshirë këtu edhe tri vite përvojë udhëheqëse.*

Rrjedhimisht, nisur nga konstatimi si më sipëri nuk qëndron pretendimi i organit të punësimit si në përgjigjen në ankesë se nëpunësi civil (në këtë rast ankuesi) sipas Akt emërimit të datës 01.01.2012 ka qenë i vendosur në kategorinë funksionale me koeficient 8, e që ishte pozitë e nivelit profesional, për

faktin së koeficienti i pagës sipas Aktit të emërimit të datës 01.01.2012 nuk është përcaktues i kategorizimit të një pozitë, sepse, kategorizimi në kategori dhe klasa bëhet në përputhje me rëndësinë, lirinë në vendimmarrje, vështirësinë e kërkuar dhe kërkesat e përgjithshme formale të nevojshme që duhet të zotërojë mbajtësi i një pozite për kryerjen e punës në klasën përkatëse, në pajtim me paragrafin 3 të 38 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik me të cilin përshihet se: *Çdo pozitë e shërbimit civil klasifikohet si pjesë e një klase të caktuar në bazë të përshkrimit të detyrave të punës.* Për me tepër, në kontekst të qëndrimit të organit të punësimit së ankuesi ka pas pozitë të klasës profesionale, Kolegji nga provat e lëndës ka gjetur së më hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, ankuesi ka realizuar pagë si drejtues i ulët klasa I9 dhe koeficient 7.4, fakt ky i vërtetuar përmes dëshmisë së lëshuar nga Thesari i Kosovës.

Tutje, sipas Rregullores Nr. 01/2024 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në AKKVP, në kuadër të Zyrës Regjionale në Mitrovicë është paraparë vetëm një pozitë e nivelit drejtues dhe atë pozita e Udhëheqësit të Zyrës Regjionale, e për të cilën sipas provave të lëndës të dërguar nga ankuesi, AKKVP më datë 20.01.2025 ka shpallur Konkursin me Nr. reference RN00016383 për pozitën Udhëheqës i Zyrës Regjionale në Mitrovicë me klasë të pozitës Drejtues i Ulët, andaj, AKKVP bazuar në nenin 130 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka qenë e obliguar që mos të inicioj asnjë procedurë të rekrutimit pa përfunduar procesi i ristrukturimit të stafit sipas rregullores së re të organizmit dhe rrejdhimisht ashtu siç është kërkuar edhe në kërkesën në përgjigje në ankesë të pezulloj procedurën lidhur me konkursin me Nr. reference RN00016383 deri në vendosjen përfundimtare sipas ankesës së ankuesit, ngase, shpallja e këtij konkursi ka cenuar të drejtat e ankuesit në ristrukturim.

Bazuar në të gjeturat dhe konstatimet si më sipër, Kolegji erdhi në përfundimin së organi përkatësi i punësimit, në këtë rast Komisioni i Ristrukturimit i AKKVP-së, nuk ka zbatuar dejtë ligjin material me rastin e propozimit të transferimit të ankuesit duke vepruar kështu në kundërshtim të plotë me nenin 66 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 12, 13 dhe 14 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, ndërsa, Vendimi Nr. 75/2024 i datës 23.12.2024, i Udhëheqësit të Divizionit të Burimeve Njerëzore të AKKV-së është nxjerr në kundërshtim me nenin 66 paragrafi 4 Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, dhe nenin 14 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, andaj, akti i kundërshtuar me ankesë është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5, 1.6 dhe 1.7 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative,

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të*

inicijohet konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.152/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit B.V;
- Organit të punësimit: Drejtorit Ekzekutiv, Komisionit të Ristrukturimit dhe Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në AKKVP;
- Arkivit të KPMSHCK-së;